



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 11.12.2012
Nr. 0204-1305

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, Nr.01.353-44601/463-44606/353-44629/644-44611/400-44600/400-44957, të pranuar me datën 06.12.2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimeve. Nr.01. Nr.01.353-44601/463-44606/353-44629/644-44611/400-44600/400-44957, të miratuar me datë 04.12.2012 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se të njëjtit janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve në pronësi të komunës;
- Vendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Nëntë Jugoviq;
- Vendimi për dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhimin NPL "Hortikultura" SH.A;
- Vendimi për miratimin e planit të veprimtë rinor lokal-Prishtinë 2013-15;
- Vendimi për lejin e mjeteve Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" ;
- Vendimi për lejin e mjeteve Ndërmarrjes Publike lokale "Trafiku Urban" SH.A;

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministërstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 11.12.2012
br. 0204-1305

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući skupštine opštine Priština

Predmet: Potvrda zakonitosti odluka skupštine opštine Priština
br.01.353-44601/463-44606/353-44629/644-44611/400-44600/400-44957,
primljeno dana 06.12.2012

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/z-040 o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, zakon br. 03/z-049 o finansijama lokale uprave, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011. o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva, nakon razmatranja odluka br.01. 353-44601/463-44606/353-44629/644-44611/400-44600/400-44957, usvojeno dana 04.12.2012 od strane skupštine opštine Priština, **POTVRĐUJE** zakonitost akta i procenjuje da su isti ti akti u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akti sa potpunim pravnim efektom su, kao što sledi:

- Odluka o dodeli na korišćenje opreme i objekata u vlasništvu opštine;
- Odluka o određivanju lokacije groblja sela Nëntë Jugoviq-Devet Jugovića;
- Odluka o davanju komemorativne zgrade na korišćenje i upravljanje NPL "Hortikultura" SH.A;
- Odluka o usvajanju akcionog omladinskog lokalnog plana -Priština 2013-15;
- Odluka o dozvoli sredstava regionalne kompanije otpada "Pastrimi-Čistoća";
- Odluka o dozvoli sredstava javnog lokalnog preduzeća "Trafiku Urban-Gradski saobraćaj" Š.A;

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Direktorima odeljenja i kancelarija
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2, pika d dhe të nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 24 të Ligjit nr. 04/L - 049, për zjarrfikje dhe shpëtim, të nenit 5 të Udhëzimit administrativ nr. 21/2012 - MPB, për transferimin e shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit në njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit nga Komunitet në MPB - AME dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02. 2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2012, merr këtë

V E N D I M
P Ë R

DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PAJISJEVE DHE MJETEVE NË PRONËSI TË KOMUNËS

I.

Miratohet Vendimi për dhënie në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve tjera në pronësi të Komunës - Sektorit të zjarrfikjes dhe shpëtimit.

II.

Pajisjet dhe mjetet e tjera, të cilat deri në marrjen e këtij vendimi janë shfrytëzuar nga Sektori i zjarrfikjes dhe shpëtimit i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, do t'i transferohen në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme - Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

III.

Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, pajisjet dhe mjetet tjera do t'i shfrytëzojë derisa të ushtrojë veprimtarinë e saj pranë MPB-së.

IV.

Mënyra e shfrytëzimit të pajisjeve dhe mjeteve tjera të dhënë në shfrytëzim do të rregullohet me marrëveshje të veçantë, të lidhur në pajtim me dispozitat e UA-së për transferimin e shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit në njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit nga Komuna në MPB - AME.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Financave dhe Pronës.


VI.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 463 - 44606, më 04.12.2012

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Sami Hamiti, ecc./i dipl.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2012, miratoi këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT TË VARREZAVE NË FSHATIN NËNTË JUGOVIQ

I.

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Nëntë Jugoviq.

II.

Lokacioni nga pika I e këtij Vendimi, është parcela kadastrale nr. 688 - 0, Zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Certifikata e pronësisë 19 - 2634, me kulturë mal, klasa II, në sipërfaqe prej 8216 m², pasuri shoqërore, shfrytëzues Komuna e Prishtinës.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Financave dhe Pronës, Drejtoria e Kadastrit dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

IV.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlejë Vendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Bërnice e Epërme, 01 nr. 353 - 583, të dt. 27.12.2006.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes dhe ueb faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 353 - 44601 dt. 04.12.2012



KRYESUESI I KUVENDIT
Samir Hamiti, ecc. i dipl.



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2012, miratoi këtë

V E N D I M

PËR DHËNIEN E OBJEKTIT KOMEMORATIV NË SHFRYTËZIM DHE MENAXHIM NPL "HORTIKULTURA" SH.A.

I.

1. Miratohet Vendimi për dhënie e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhim të NPL "HORTIKULTURA" SH.A., në afat prej 10 viteve, me mundësi të vazhdimit.
2. NP "Hortikultura" SH.A., është në pronësi të Komunës së Prishtinës me 100 % të aksioneve, e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Certifikata e regjistrimit të biznesit nr. 70878569.

II.

Objekti nga pika 1 të cekur në I të këtij Vendimi, është në pronësi të Komunës, i ndërtuar në pjesët e parcelave kadastrale nr. 691, 692, 694 dhe 696, Zona kadastrale Prishtinë, në kuadër të kompleksit të varrezave të qytetit të Prishtinës, lagjja "Arbëria".

III.

Shfrytëzimi dhe menaxhimi me objektin sipas këtij vendimi, duhet të bëhet sipas destinimit të përcaktuar me projektin në bazë të cilit është ndërtuar dhe pa të drejtë tjetërsimi të personi i tretë.

IV.

Mënyra dhe kushtet tjera më të përafërta të shfrytëzimit dhe menaxhimit të objektit sipas këtij vendimi, do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë, të lidhur në mes të Komunës dhe NPL "Hortikultura" SH.A.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, ndërsa drejtoritë tjera do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me ligj.


VI.

Ky Vendim hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.nr. 353 - 44629 më 04.12.2012

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Sami Hamiti, ecc. i dipl.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 03/L – 145, për fuqizimin dhe pjesëmarrje të rinisë, të nenit 10, pikat 1.2, 1.3, 2.6, 2.8 të Udhëzimit administrativ nr. 9/2010 për përgjegjësin dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2012, merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL - PRISHTINË 2013 - 2015

I.

Miratohet Vendimi për Planin e veprimit rinor lokal - Prishtinë 2013 – 2015.

II.

Plani i veprimit, i cekur në pikën I të këtij vendimi, është bazuar në dispozitat e ligjit në fuqi për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimet rinore.

III.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kopja e Planit të veprimit rinor lokal – Prishtinë, për periudhën 2013 – 2015.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

V.


Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 644 - 44611, më 04.12.2012

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Sami Hamiti, ecc. i dipl.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.12.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2012 merr

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE KOMPANISË RAJONALE TË MBETURINAVE
"PASTRIMI" PRISHTINË

I.

MIRATOHET Vendimi për lejimin e mjeteve KRM "Pastrimi" në Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të lejuara, sipas pikës I të këtij Vendimi, është 100.000,00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës komunale 22 - 163, mjete nga të hyrat vetanake.

III.

Qëllimi i Vendimit është dhënia e ndihmës, që Komuna e Prishtinës i ndan KRM "Pastrimi" me seli në Prishtinë, për tejkalimin e problemit me Kompaninë e Menaxhimit të Mbeturinave.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe e Pronës.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 400 - 44600, më 04.12.2012



KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.12.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2012 merr

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE
"TRAFIKU URBAN" SH.A. NË PRISHTINË

I.

MIRATOHET Vendimi për lejimin e mjeteve NPL "Trafiku Urban" SH.A. në Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të lejuara, sipas pikës I të këtij Vendimi, është 50,000.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës komunale 22-163, mjete nga të hyrat vetanake.

III.

Qëllimi i Vendimit është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës ia ndan NPL për blerje të autobusëve.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe e Pronës.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 400 - 44957, më 04.12.2012



KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.